STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 11 korrik 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NENSHKRUAN LEGJISLACIONIN PER TE LEJUAR BANORET E BRIZI POINT (BREEZY POINT) QE TE PERSHPEJTOJNE RIPARIMET E SHTEPIVE TE DEMTUARA NGA SUPER STUHIA SENDI (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) nënshkroi sot legjislacion që t'u lejojë banorëve të Brizi Point (Breezy Point) të përshpejtojnë riparimet e shtëpive të dëmtuara nga super stuhia Sendi (Sandy). Ligji i ri do t'u lejojë pronarëve të shtëpive në Brizi Point (Breezy Point) që të anashkalojnë kërkesa të lejeve që duan kohë në mënyrë që të fillojnë të riparojnë dhe të restaurojnë shtëpitë dhe jetën e tyre.

"Përpara ditës së sotme, banorët e Brizi Point (Breezy Point) përballeshin me mundësinë e pritjes së deri në një vit për miratimin për të rindërtuar shtëpitë e shkatërruara nga super stuhia Sendi (Sandy)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Nënshkrimi i ketij ligji eleminon burokracinë e panevojshme, duke u dhënë këtyre banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers) një rrugë më të lehtë përpara ndërsa vazhdojnë të restaurojnë shtëpitë dhe lagjen e tyre."

Senatori Jozef P. Adabo Jr. (Joseph P. Addabbo, Jr.) tha, "Si përfaqësuesi i Senatit për komunitetet që u goditën veçanërisht rëndë nga super stuhia Sendi (Sandy) jam shumë i kënaqur që Guvernatori Kuomo (Cuomo) dhe kolegët e mi nga të dyja partitë, në të dyja dhomat e Kongresit, u bashkuan në miratimin e legjislacionit që do të ndihmojë në rindërtimin dhe rimëkëmbjen nga stuhia, ndërsa përgatitemi më mirë për ngjarje të tilla katastrofike në të ardhmen. Vlerësoj veçanërisht se legjislacioni për të ndihmuar banorët e Brizi Point (Breezy Point) në rindërtimin e shtëpive të tyre pas përmbytjes së tmerrshme të Sendit (Sandy) u miratua nga Guvernatori. Jam optimist se ky legjislacion do të lehtësojë kërkesat për leje ndërtimi për banorët e Brizi Point (Breezy Point), të cilët përndryshe do të detyroheshin të përballeshin me vonesa të pafundme në rindërtimin e shtëpive dhe jetës së tyre. Besoj se njerëzit e Brizi Point (Breezy Point) duruan disa dëmtimet më të rënda të përjetuara në shtetin tonë. Ndërsa ka dhe do të ketë më shumë çështje që kanë lidhje me Sendin (Sandy) që kërkojnë veprim të shpejtë dhe të efektshëm qeveritar, besoj se ky ligj do të çojë përpara në mënyrë të konsiderueshme përpjekjet tona të rimëkëmbjes."

Anëtari i Asamblesë Filip Golldfedër (Phillip Goldfeder), “Kjo është një fitore e madhe për familjet tona në Brizi Point (Breezy Point) që ende përpiqen të rimëkëmben nga Sendi (Sandy). Kanë kaluar më shumë se 8 muaj që kur Sendi (Sandy) shkatërroi pothuajse 135 shtëpi nga zjarri dhe qindra të tjera nga përmbytja në Brizi Point (Breezy Point). E hartova këtë legjislacion për të hequr rregullat arkaike dhe të vjetëruara dhe për të lejuar që familjet të fillojnë rindërtimin menjëherë. Përgëzoj kolegët e mi në Asamble dhe Senat për mbështetjen e tyre dhe Guvernatorin për nënshkrimin e këtij ligji për të siguruar një rimëkëmbje të plotë në komunitetet e goditura më rëndë.”

Si rezultat i super stuhisë Sandi (Sandy) dhe një zjarr të madh që ndodhi gjatë stuhisë, shumë shtëpi të Brizi Point (Breezy Point) dhe ndërtesa të tjera u dëmtuan rëndë ose u shkatërruan plotësisht. Për shkak të shtrirjes unike të Brizi Point (Breezy Point), shumë pronarë të ndërtesave që dëshirojnë të rindërtojnë ose të bëjnë riparime të ndërtesave kërkohet të bëjnë kërkesë për një leje të posatçme, kërkesa dhe shqytimi i të cilës mund të kërkojnë më shumë se 12 muaj për t’u përfunduar. Ligji i ri i nënshkruar sot nga Guvernatori (A4835B/S3736-B) do të heqë për një vit kërkesën e miratimit për pronarët e ndërtesave të Brizi Point (Breezy Point) që kanë përjetuar dëmtim të konsiderueshëm në pronat e tyre si rezultat i Sendit (Sandy).

Ligji i ri do të hyjë në fuqi menjëherë.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418